

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje automjet teknologjik per mbetjet urbane, Bashkia Puke

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjete 34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

5,652,259 (Pesemilion e gjashtëqinde e pesedhjetë e dymije e dyqinde e pesedhjetë e nente) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

c. *Formulari ofertës sipas shtojcës 1*

d. *Listat e çmimeve të artikujve sipas shtojcës 2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 40% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohej për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomik të vegjël apo të mëdhenj. *Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben AK për të vërtetuar se op.ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratë*

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/ date 05.03.2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021 dhe 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit**

kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kerkohej për 2 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3. a. Furnizime të ngjashme me një vlerë **me një vlerë jo më të vogël** se 20 % të **te vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit për përmbushje me sukses të kontratës të shoqëruar me kontratën e lidhur me Autoritetin Kontraktor dhe Operatorin Ekonomik dhe fatures.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit për këto objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedurë vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

b. b. Op.ekonomik të paraqes dokumentacionin teknik ligjor që posedon mjetin në çdo formë ligjore sipas ligjit Shqiptarë që vërteton se ka posedim të ligjshëm mbi këto mjet që ofron dhe të

dhena qe eshte sipas specifikimeve teknike te percaktuara si dhe foto te mjeteve.Mjeti duhet te kete dokumentacionin e plote juridik sipas legjislacionit shqiptar perfshire dhe doganen e paguar ose op.ekonomik te marre persiper ne rast shpallje fitues do marr persiper likujdimin e vleres per plotesimin e dokumentacionin sipas legjislacionit shqiptar perfshire dhe doganen. Ky dokumentacion do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

Kriteri eshte i mbeshtetur ne nenin 40 pika 6 dhe 8 te VKM nr. Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.Ky kriter eshte vendosur per te deshmuar qarte op.ekonomik verteton se ka posedim te ligjshem mbi kete mjet qe ofron ne cdo forme ligjore sipas ligjit Shqiptare dhe jane sipas specifikimeve teknike te percaktuara si dhe foto te mjetit.Gjithashtu merr persiper plotesimin me dokumentacionin teknik si leje qarkullimi e vlefshme,siguracion dhe taksa automjetesh dhe me ane te nje deklarate per te mos diskriminuar asnje op.ekonomik qe ne momentin e hedhjes se ofertes mund te kete mjetin te pa targuar apo paisur me dokumentacion perkates.Kjo behet pasi vlera e doganes eshte perfshire ne fondin limit nga ana e preventivuesit bazuar ne projektin e fituar ne BE .

c.Op.ekonomik duhet te paraqes vertetim per shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga pushteti vendor per vitin 2022.Ne rastin e bashkimit te op.ekonomik ,çdo antar i grupit duhet te dorzoje vertetimin e leshuar nga Autoritete perkatese ne te cilin eshte regjistruar sipas QKB.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

d.Op.ekonomik duhet te sjelle vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka op,ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi:Kjo kerkese eshte e bazuar ne piken 7 germa "a" neni 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" per te provuar se op.ekonomik vepron konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

Grafiku i levrimit 30 dite pas lidhjes se kontrates eshte percaktuar si kohe e nevojshme per furnizimin objekt i ketij prokurimi duke marre parasysh qe mjeti mund te ndodhet brena territorit Republikes Shqiperise apo dhe jashte saje per te qen afat i mjaftushem per te siguruar konkurence te drejte dhe te ndershme dhe ne perputhje me afatet per zbatimin e projektit te BE.

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialist i jashtem i përcaktuar nga Titullari AK ne mungese te nje Inxhinieri Mekanik ne Bashkine Puke specififikimet jane bazuar ne projektin e aplikuar dhe fituar prane Bashkimit European dhe ne përputhje me studimin e tregut eshte caktuar vlera nga preventivuesi.

Njesia Prokurimit